

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

Duke u bazuar në nenin 4 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenet 27 dhe 28, të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës (tani e tutje "KPK") miraton:

R R E G U L L O R E Nr. 06/2012
Për
CAKTIMIN DHE TRANSFERIMIN E PËRSONELIT MBËSHTETËS

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë rregullore caktohen procedurat për caktimin dhe transferimin e personelit mbështetës në Prokuroritë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në strukturën organizative të përcaktuar me Ligjin për Prokurorin e Shtetit.
2. Për qëllim të kësaj rregullore caktimi i personelit mbështetës nga prokuroritë komunale dhe të qarkut në prokuroritë themelore dhe atë të apelit, në pozitën dhe gradën e njëjtë do të konsiderohet transferim.

Neni 2
Parimet bazë

1. Gjatë caktimit dhe transferimit të personelit mbështetës, procesi do të udhëhiqet nga parimet si në vijim:
 - 1.1. Respektimi i shumëllojshmërisë etnike (Neni 5 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit);
 - 1.2. Parimet ndërkombëtare të barazisë gjinore (Neni 5 për Prokurorin e Shtetit); dhe
 - 1.3. Përfshirjen gjeografike.

Neni 3

Organizimi i Prokurorive

1. Sipas Ligjit, Prokuroritë e Republikës së Kosovës nga data 01 janar 2013 organizohen si në vijim:
 - 1.1 Prokuroria Themelore e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm, nga Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda;
 - 1.2 Prokuroria e Apelit e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda;
 - 1.3 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës; dhe
 - 1.4 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 4

Caktimi dhe transferimi

1. Parimisht, personeli mbështetës në detyrë në prokuroritë komunale, do të transferohen në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore.
2. Parimisht, personeli mbështetës në detyrë në Prokuroritë e Qarkut, do të caktohen në Departamentet e Specializuara të Prokurorive Themelore bazuar në përvojën dhe performancën e tyre.
3. Caktimi dhe transferimi i personelit mbështetës në Prokurorinë e Apelit, do të bëhet përmes një njoftimi të brendshëm, me të drejtë aplikimi nga të gjithë personeli aktual në prokuroritë e qarkut dhe ato komunale.
4. Njoftimi i brendshëm dhe formati i aplikimit do të shpallen në webfaqen e PSH nga sekretariati i ZKPSH.
5. Paragrafi 1, 2 dhe 3 i këtij neni nuk do të zbatohen për administratoret e prokurorive komunale dhe atyre të qarqeve.

Neni 5

Komisioni për caktimin dhe transferimin e personelit mbështetës

1. KPK do të themelojë Komision për caktimin e numrit të nevojshëm për personel mbështetës në prokuroritë përkatëse në pajtim me vëllimin e punës dhe personelit mbështetës aktual të lejuar me buxhet.
2. Komisioni i themeluar sipas paragrafit 1 të këtij neni do të jetë përgjegjës edhe për identifikimin, caktimin dhe transferimin e personelit mbështetës nga struktura aktuale në strukturën e re të sistemit prokurorial.
3. Komisioni sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bazohet po ashtu në vendimin e KPK-së Nr. 445/2012, të datës 17 prill 2012, "për Caktimin e Numrit të prokurorëve në Prokuroritë Themelore dhe në Prokurorinë e Apelit.

Neni 6

Caktimin dhe transferimi i administratorëve

1. Komisioni gjatë caktimit dhe transferimit të administratorëve do të bazohet në vlerësimin e performancës së administratorëve dhe në rezultatet e treguara në punë.
2. Administratorët që nuk propozohen ng Komisioni në poziten e administratorit të prokurorisë themelore do të caktohen në pozitë tjetër në pajtim me kualifikimin dhe përvojën e punës.
3. Administratorët e pakënaqur me vendimin e Komisionit kanë të drejtë ankese në afat prej 8 (tetë) ditësh tek Komisioni ad hoc për ankesa i përcaktuar me nenin 9 të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Përbërja dhe vendimmarrja e Komisionit

1. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë dhe mund të punojë vetëm kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët.
2. Kryetar i Komisionit do të caktohet një anëtar i KPK-së.
3. Anëtarët e tjerë të Komisionit do të jenë:
 - (a) Një kryeprokuror i Prokurorisë së Qarkut;
 - (b) Një zyrtar nga zyra e burimeve njerëzore; dhe
 - (c) Dy zyrtarë nga Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive.

4. Komisioni do të marrë vendim me shumicë të votave.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni do të ushtroje përgjegjësitë e veta duke u bazuar në dispozitat e kësaj rregullore.
2. Komisioni do të respektojë vullnetin e personelit mbështetës gjatë caktimit dhe transferimit, përveç kur kjo është e domosdoshme për të siguruar dhe lehtësuar fazën kalimtare nga struktura aktuale në strukturën e re organizative të sistemit prokurorial.
3. Komisioni do të sigurohet, që çdo herë kur të jetë e mundur, të caktojë stafin mbështetës brenda vendndodhjes së tyre gjeografike.
4. Personeli mbështetës mund të kërkojë të transferohet nga një prokurori e nivelit më të lartë në një prokurori të nivelit më të ulët.
5. Komisioni përcakton numrin e nevojshëm të personelit mbështetës për secilën prokurori, identifikon personelin mbështetës që duhet të transferohet dhe njofton të njëjtit përmes publikimit të emrave në faqen zyrtare të Prokurorit të Shtetit.
6. Personeli i pakënaqur me vendimin e Komisionit ka të drejtë ankese në afat prej 8 (tetë) ditësh tek Komisioni ad hoc për ankesa i përcaktuar s me nenin 9 të kësaj rregulloreje.
7. Vendimi i komisionit për transferim së bashku me vendimin e Komisionit Ad Hoc për ankesa i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje përfundimtare KPK-së.
8. KPK merr vendim për caktimin dhe transferimin e personelit mbështetës.
9. Drejtori i përgjithshëm i SZKPSH është përgjegjës për zbatimin e vendimit të KPK-së.

Neni 9

Komisioni për ankesa

1. Komisioni për ankesa themelohet nga KPK dhe përbëhet nga tre anëtarë.
2. Komisioni do të përbëhet nga një anëtarë i KPK-se, i cili do të jetë Kryetar i Komisionit; dhe dy anëtarë nga Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive.


3. Kompetencë e këtij komisioni është shqyrtimi i ankesave të ushtruara kundër vendimeve të Komisionit për Caktim dhe Transferim të personelit mbështetës.
4. Komisioni shqyrton dhe vendosë për ankesat në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ankesës.
5. Gjatë vendosjes për ankesë, komisioni do të bazohet në nenin 28.2 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe këtë rregullore.

Neni 10 Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar me datën 10 gusht 2012.



Ismet Kabashi

Kryetari i Këshillit Prokurorial